



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 377/12 prot.

Tiranë, më 05.06.2025

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 05.06.2025

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA E MJEKËSISË SË PUNËS”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Qendra e Mjekësisë së Punës” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 67, datë 27.03.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetësja I.D, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi, është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L91325020J, me objekt të aktivitetit, ofrimin e shërbimit mjekësor nga mjeku i punës ose mjekë të sëmundjeve profesionale, për kompanitë, të cilave u nevojitet sipas

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

legjislationit përkatës; Vlerësimi i riskut për kompanitë; Ofrimi i ekzaminimeve mjekësore; etj.;

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë Kontrolluesi mbledh dhe përpunon ndër të tjera, të dhëna personale për kategorinë “punëmarrës”.

2. Zyra e Komisionerit, ka administruar ankesën me nr. 977 prot., datë 17.03.2025, nëpërmjet të cilës ankuesja I.D, pretendon se Kontrolluesi ka instaluar sistemin e video-survejitimit CCTV në ambientin e zyrës ku punon, pa pëlqimin e saj.

Gjithashtu, ankuesja pretendon se, Kontrolluesi ka keqpërdorur të dhënat e saj personale duke i përhapur ato pranë Bankës së Parë të Investimeve Albania SHA (FiBank), për të krijuar një llogari bankare, pa dijenin e saj.

3. Gjatë hetimit administrativ konstatohet se, Kontrolluesi ka instaluar sistemin e video-survejitimit CCTV dhe një nga kamerat është instaluar në zyrën e financës, ku është vendosur edhe kasaforta, me qëllim sigurinë e ambienteve, kryesisht për evidentimin në rast vjedhje.

Kamera në zyrën e financës është e pozicionuar në mënyrë të tillë që monitoron kasafortën por edhe postin e punës/kompjuterin e ankueses, në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe pikës 2 të Udhëzimit nr. 3 datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejitimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejitimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme si “imazhe” dhe “video”, janë të dhëna personale, dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

Instalimi dhe përdorimi i sistemeve CCTV, që përpunojnë të dhënat personale, duhet të jetë në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, si e drejta për jetën private, familjare dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, pozicioni i kamerave nuk duhet të jetë në një mënyrë, nga e cila përftohen imazhe nga mjedise që nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

4. Sa i përket përhapjes së të dhënave personale të ankueses pranë FiBank, Kontrolluesi nëpërmjet email-it të datës 03.04.2025 dhe 07.04.2025 ka bërë me dije se “...ju konfirmojmë që llogaria pranë bankës FI-BANK është hapur në dijeni të shtetases (bisedë telefonike dhe komunikim me sms ku na janë dërguar të dhënat) siç janë hapur

llogaritë për punonjësit e tjerë për të kaluar pagat mujore të kompanisë”, duke bashkëlidhur edhe screenshot të bisedave me ankuesen.

Nga verifikimi i bisedave me ankuesen rezulton se, ankuesja ka konfirmuar të dhënat për një punonjës tjetër lidhur me hapjen e llogarisë pranë FiBank dhe jo për të dhënat personale të saj.

Për sa më sipër, konstatohet se përhapja e të dhënave personale të ankueses pranë FiBank është kryer në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryhet duke pasur parasysh respektimin e parimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe kriterëve ligjore për përpunimin e të dhënave personale, sanksionuar në nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

Përhapja e të dhënave e subjekteve të të dhënave (në rastin konkret të ankueses), konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 7 të Ligjit. Sipas pikës 1, të nenit 7 të Ligjit, përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse dhe për aq sa përmbushet të paktën njëri prej kriterëve, ku ndër të tjera janë parashikuar: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... c) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;...*

Në këtë rast, kërkesa për konfirmimin e të dhënave të ankuesit duhet të bazohet në një parashikim ligjor konkret me qëllim që përhapja të konsiderohet e ligjshme.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave për subjektet e të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit. Hartimi i rregullave specifike nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve, nenet 6, 7, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 6 dhe 7 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, të marrë masa për ripozicionimin e planit të monitorimit përmes sistemit CCTV;
2. Kontrolluesi, të hartoj rregulla specifike për të garantuar përpunimin/përhapjen e ligjshme të të dhënave personale, në raste të ngjashme;
3. Kontrolluesi, të këtë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;
4. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
 - (iii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 3 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
6. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 05.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi